

Tiranë, 10.03.2023

## DEKLARATË

### LIDHUR ME ANGAZHIMIN SOLEMN TË KRYETARËVE TË PARTIVE KUNDËR PRAKTIKAVE ABUZIVE TË BLERJES SË VOTËS

Instituti i Studimeve Politike (ISP) mirëpret depozitimin në KQZ të angazhimit solemn të kryetarëve të partive politike, sipas të cilit *“pjesëtarët e strukturave drejtuese dhe administrative, të anëtarësisë, kandidatëve për deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore, deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore dhe gjithë strukturave të tjera të angazhuara nga subjekti në këto zgjedhje, funksionarë/ ish funksionarë publik do të refuzojnë të marrin pjesë në praktikat e blerjes së votës”*.

Çdo formë e trafikimit të votës, përfshirë rastet e blerjes së votës të cituara në rekomandimet prioritare të ODIHR/OSBE dhe rastet e cituara në zgjedhjet e brendshme të vetë partive politike, përbëjnë akte që minojnë parimet kushtetuese dhe standardet e shtetit të së drejtës, si dhe që komprometojnë legjitimitetin e institucioneve përfaqësuese dhe institucionin e votës në Shqipëri.

- Raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe studime profesionale, përfshirë studime, sondazhe dhe gjetje të Institutit të Studimeve Politike (ISP) theksojnë nivelin e lartë të trafikimit të votës në Shqipëri dhe shqetësimin e madh për fenomenin e blerjes së votës.
- Numri i rasteve të raportuara është në disproporcion të thellë me numrin minimal të rasteve të hetuara dhe gjykuara nga organet ligjzbatuese, ndërkohë që asnjë kandidat, zyrtar apo anëtar e përfaqësues i partive politike, i përfshirë në blerjen e votës, nuk është penalizuar nga partia e vet politike.

- Në kundërshtim me angazhimin solemn në KQZ, gjatë disa zgjedhjeve të fundit parlamentare dhe lokale, individët partiakë të identifikuar direkt ose indirekt si ushtrues apo mbështetës të blerjes së votës, janë promovuar në poste më të larta politike, duke e konsideruar këtë akt si aftësi dhe meritë, jo si cilësi negative.
- Ka pasur raste kur partitë kanë përjashtuar apo penalizuar individë që kanë abuzuar me votën në zgjedhjet e brendshme partiake, por asnjë rast në zgjedhjet lokale dhe parlamentare, - një tregues tjetër që partitë ndjekin standarde të dyfishta dhe abuzimin “në familje” e lejojnë dhe e promovojnë kur kthehet në abuzim ndaj votës qytetare dhe votës së “tjetrit” në zgjedhjet lokale dhe parlamentare.

Shqipëria mbetet një prej vendeve evropiane me nivelin më të lartë të trafikimit të votës, ndaj sfida kryesore e zgjedhjeve të majit 2023 duhet të jetë reagimi, reflektimi dhe ndryshimi thelbësor në këtë çështje.

- Ata që trafikojnë vota ose miratojnë praktikën e blerjes së votës nuk mund të jenë reformatorë, shtetarë, të zgjedhur legjitim, inspirues për brezat e rinj dhe as modele pozitive në politikë dhe përfaqësim.
- Ata individë dhe ato parti politike që nxisin, ushtrojnë dhe promovojnë blerjen e votës kryejnë akte penale ndaj shtetit, qytetarëve dhe interesave të vendit.

Instituti i Studimeve Politike (ISP) nxit partitë të mbajnë përgjegjësi për aktet e tyre, kryetarët e partive të respektojnë angazhimin solemn, KQZ të investohet më shumë në standardet e integritetit të zgjedhjeve, Prokurorinë dhe SPAK të ofrojnë standarde më të larta drejtësie për rastet e abuzimit me votën, organet e tjera ligjzbatuese për jetësimin integral të ligjit, median, shoqërinë civile dhe qytetarët të informojnë dhe denoncojnë çdo rast abuzimi.

Shqipëria meriton një elitë politike më të aftë, më të pastër, më të përgjegjshme, më llogaridhënëse dhe më me integritet.

*Instituti i Studimeve Politike (ISP)*